



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1 Prot.

Tiranë, më 26/7/2010

Lënda: Mbi inspektimin , datë 15.07.2010, në Televizionit Kombëtar Klan.

URDHËR

Nr. 1 , datë 26/7/10

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të materialit të inspektimit dhe relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të Televizionit Kombëtar Klan;

KONSTATOVA

Më datë 15/07/2010 nga grupi i kontrollit të zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë jush, me cilësinë si kontrollues që mblidhni dhe përpunoni të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit tuaj, me objekt:

- Verifikimi i ankimit të znj. Z.K., mbi publikimin e të dhënave të saj me cilësinë e birësueses dhe të birësuarit të saj, në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës dhe nenet 11 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Komisioneri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast dhe provat e administruara , konstaton:

1) Kontrolluesi TV “Klan” ka shkelur nenin 11 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” pasi të dhënat e mësipërme nuk janë mbledhur, përpunuar dhe publikuar për qëllime gazetarie, literature ose artistike, ç’ka do të përjashtonte kontrolluesin nga respektimi i neneve 5, 6, 7, 8, 12, 18, 21 e 28, të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, “Përpunimi i të dhënave personale vetëm për qëllime gazetarie, literature ose artistike përjashtohet nga zbatimi i neneve 5, 6, 7,

Rr “Abdi Toptani”, ish/ Ministria e Transporteve, kati i II-të, nr.4
Tiranë
Tel:+355 42 2237200

8, 12, 18, 21 e 28 të këtij ligji, vetëm nëse mbrojtja e të dhënave personale, sipas këtyre dispozitave, pengon ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes”.

2) Kontrolluesi TV “Klan” gjatë mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të të dhënave personale që lidheshin me rastin që po trajtonte në emisionin “Njerëz të humbur”, gjendet përballë kufizimeve ligjore, për sa i përket lirisë së shprehjes dhe të drejtës së informimit, kufizime këto të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8, 12, 18, 21 e 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” të bëra mbi bazën e nenit 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, “1 Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. “

3) Kontrolluesi ka shkelur nenet 36, 37 të ligjit nr. 9695 datë 19.03.2007 “ Për procedurat e birësimit dhe komitetin shqipëtar të birësimit”, 1”.Komiteti dhe agjencitë ndërmjetësuere marrin masa organizative dhe teknike të domosdoshme për mbrojtjen e të dhënave personale në dokumentacionin birësues në përputhje me kërkesat e ligjit “Për mbrojtjen e të Dhënave personale”. 2.Punonjësit publikë dhe privatë që për shkak të detyrës kanë informacion për birësimin detyrohen të ruajnë sekretin për të dhënat që kanë të bëjnë me fëmijën, prindërit biologjike dhe birësuesit.”, 1.” Prindërit birësues dhe i birësuarit që ka arritur moshën madhore, mund ti kërkojnë Komitetit të dhëna për origjinën e të birësuarit dhe historinë e tij.”

- Ligji i jep të drejtën vetëm familjes birësuese dhe të birësuarit për të vendosur rreth origjinës së të birësuarit apo për të mbledhur të dhëna rreth historisë së birësimit. Nga inspektimi rezultoi se kontrolluesi TV“ Klan” emisioni “ Njerëz të humbur” është vënë në lëvizje me kërkesë të shtetasës M. (nëna biologjike) e fëmijës.

4) Kontrolluesi ka shkelur nenin 36 të ligjit nr. 8410 datë 30.09.1998 i ndryshuar “ Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë, “Programet radiotelevizive publike dhe private respektojnë dinjitetin vetjak dhe të drejtat themelore të njeriut, paanshmërinë, plotësinë dhe pluralizmin e informacionit, të drejtat e fëmijëve dhe të adoleshentëve, rendin publik dhe sigurinë kombëtare, gjuhën dhe kulturën shqiptare, të drejtat kushtetuese e njerëzore të shtetasve, të pakicave kombëtare në përputhje me konventat ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë, diversitetin fetar shqiptar.”

- Kontrolluesi gjatë mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të të dhënave për rastin që ka trajtuar nuk ka respektuar këtë dispozitë të ligjit, konkretisht dinjitetin vetjak të prindërve birësues dhe të vetë birësuesit, për më tepër gazetarët nuk mund të bëjnë publike pa miratimin e prindërve birësues lajmin se një fëmijë është birësuar. Në një

rast të tillë bëhet fjalë për dhunim të normave të privatësisë. Në këto raste gazetarët duhet të respektojnë me rreptësi të veçantë legjislacionin e cituar më sipër si dhe të ruajnë balancën midis të drejtës së lajmit, të drejtës së informimit dhe privatësisë.

Përfundimisht, nisur sa sipër dhe mbështetur në nenet 29 dhe 30 të ligjit nr. 9887 dt. 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”;

URDHËROJ

1. Ndalimin e mbledhjes, grumbullimit, përpunimit dhe publikimit të mëtejshëm të të dhënave personale që lidhen me rastin e birësimit të fëmijës A. M, shfaqur në Televizionin Kombëtar Klan, emisionin televiziv “Njerëz të humbur”.
2. Fshirjen dhe shkatërrimin e të gjitha materialeve dhe të dhënave të grumbulluara për rastin e trajtuar në emisionin “Njerëz të humbur” që lidhet me prindërit birësues dhe të birësuarin A. M .
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)



Datë 23.07.2010